

**TIRANË – SHQIPËRI**

**AKTI I THEMELIMIT**

**DHE**


**STATUTI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**AGROPHARMA AL SH.P.K.**

**TIRANË – SHQIPËRI**

2023



Sot, në datën 30 / 05 /2023, në qytetin e Tiranës, subjektet e mëposhtëm, mbledhen dhe bien dakord të themelojnë Shoqerinë **AGROPHARMA AL SH.P.K**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar duke nënshkruar këtë Akt Themelimi dhe Statut në bazë të vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë.

- 1) AGROPHARMA SH.P.K, me seli në Viti, rruga e Preshevës p.n., Kosove, e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës me numrin e NIPT: 811274290, e cila zotëron 1 (një) kuotë të zakonshme, në vlerën 76,000.00 (shtatedhjete e gjashte mijë lekë), që përfaqëson 76% (shtatedhjete e gjashte për qind) të kapitalit të Shoqërisë "Agropharma Al" Sh.p.k;
  
- 2) Z. Enea Thomaj, lindur më 12.02.1993, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036352167 dhe nr. personal J30212028S, banues në Lushnjë, me adresë në rrugën Loni Dhamo, i cili zotëron 1 (një) kuotë të zakonshme, në vlerën 24,000.00 (njëzet e kater mijë lekë), që përfaqëson 24% (njëzet e katër për qind) të kapitalit të Shoqërisë "Agropharma Al" Sh.p.k;

## KAPITULLI I

### Emri, Forma Ligjore, Selia e Regjistruar, Kohëzgjatja

#### 1. Emri i Shoqërisë

- 1.1. Emri i shoqërisë është AGROPHARMA AL SH.P.K ("Shoqëria").
- 1.2. Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, emri i saj duhet të paraprijet ose pasohet nga fjalët "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "SH.P.K."
- 1.3. Emri tregtar i shoqërisë është AGROPHARMA AL SH.P.K

#### 2. Forma Ligjore e Shoqërisë

- 2.1 AGROPHARMA AL SH.P.K është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar në përputhje me ligjet e Shqipërisë, si edhe me dispozitat e këtij statuti ("Statuti"), si dhe çdo ndryshimi të mëtejshëm të tyre.

### **3. Selia e regjistruar e Shoqërisë**

- 3.1 Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: me seli në adresen: *Lagja e Thomenjëve, Nd. 12, Hl. Goriçaj, Gradishtë, Divjakë, Shqipëri.*
- 3.2 Shoqëria rezervon të drejtën të zhvendosë selinë e saj në një adresë tjeter në Shqipëri dhe të hapë adresën tjetër.
- 3.3 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin

### **4. Kohëzgjatja e Shoqërisë**

- 4.1 Shoqëria do të themelohet për një kohëzgjatje (afat) të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

## **KAPITULLI II**

### **Objekti i aktivitetit të Shoqërisë**

#### **5. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë**

- 5.1 Objekti i Shoqërisë do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:
  - a) Import-eksport të mallrave të ndryshme, industriale, ushqimore, bujqësore, farerave, fidaneve, plehrave, pesticideve si dhe inputeve të tjera bujqësore.
  - b) Shitjen-blerjen, të mallrave të ndryshme, industriale, ushqimore, bujqësore, farerave, fidaneve, plehrave, pesticideve si dhe inputeve të tjera bujqësore, me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë Shqipërisë;
  - c) Amballazhim dhe paketim të produkteve ushqimore, bujqësore;
  - d) Shitjen,blerjen, dhënien marrjen me qira të pasurive të paluajteshme;
  - e) Ndërtimi dhe menaxhimi i ambjenteve të mbrojtura për prodhimin dhe rritjen e fidaneve per perime, peme, lule dhe produkte bujqësore;
  - f) Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e pakice e produkteve ushqimore, bujqësore;
  - g) Promovimi, zhvillimi dhe menaxhimi i veprimit tarive bujqësore, agraro – bujqësore;

- h) Te kryeje keshillime, trajnime si dhe asistence teknike ne dobi te organizatave, bizneseve ose individeve qe kerkojne asistence te specializuar apo synojne rritjen dhe permiresimin e performances se veprimtarise se tyre;
  - i) Çdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 5.2 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten leje, licenca dhe/ose autorizime përkatëse, do të bëhet pas marries së këtyre lejeve, licencave dhe/ose autorizimeve.
- 5.3 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, për përbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria mund:
- a) të aplikojë dhe të pajiset me një ose të gjitha licencat dhe autorizimet e nevojshme, si dhe të kryejë aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përbushjen e objektit të Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara me sipër;
  - b) të blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt (objekti i aktiviteti) të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj;
  - c) të kryejë aktivitete publikimi, marketingu e reklamimi;
  - d) të kryejë aktivitete import - eksporti të mallrave dhe/apo shërbimeve siç do të konsiderohet e nevojshme;
  - e) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përbushjen e objektit të Shoqërisë.
- 5.4 Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo përqafon standardet më të mira etike.

## 6. Ndryshimi

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme (e përkufizuar më poshtë) ka të drejtë të ndryshojë objektin e aktivitetit të Shoqërisë në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.

## KAPITULLI III

### Kapitali i Regjistruar

#### 7. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë

- 7.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë do te jetë 100,000.00 (njëqind mijë) Lek, i përbërë nga 2 (dy) kuota të zakonshme, nga 1 (një) kuotë në pronësi të secilit prej ortakëve të mëposhtëm :
- (i) **AGROPHARMA SH.P.K.**, me seli në Viti, rruga e Preshevës p.n., Kosove, e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës me numrin e NIPT: 811274290 , e cila zotëron 1 (një) kuotë të zakonshme, në vlerën 76,000.00 (shtatedhjete e gjashte mijë lekë), që përfaqëson 76% (shtatedhjete e gjashte për qind) të kapitalit të Shoqërisë Agropharma Al Sh.p.k;
- (ii) **Z. Enea Thomaj**, lindur më 12.02.1993, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036352167 dhe nr. personal J30212028S, banues në Lushnjë, me adresë në rrugën Loni Dhamo, i cili zotëron 1 (një) kuotë të zakonshme, në vlerën 24.000,00 (njezet e kater mijë lekë), që përfaqëson 24% (njezet e katër për qind) të kapitalit të Shoqërisë  
Të dy së bashku në vijim do të quhen ("Ortakët").
- 7.2 Z. Enea Thomaj, individualisht do të quhen këtu edhe si "Ortaku i Pakicës".
- 7.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe do te shlyhet plotësisht me kontribute në para nga Ortakët e Shoqërisë pas themelimit dhe rregjistrimit te saj zyrtarisht prane Qendres Kombetare te Biznesit, Shqiperi.

#### 8. Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë merr vendime për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë në përputhje me dispozitat e detyrueshme të ligjit shqiptar dhe me dispozitat e këtij Statuti.
- 8.2 Kapitali do të zmadhohet me kontribute në para apo në natyrë si edhe përfshirë rezervat apo fitimet e pashpërndara të Shoqërisë.

#### 9 Përgjegjësitet e Ortakëve dhe të Shoqërisë

- 9.1 Ortakët angazhohen të përmbushin qëllimin dhe të realizojnë Projektin për të cilin kjo Shoqëri është themeluar;

B. S.

- 9.2 Ortakët, në përputhje me fushën e veprimitarisë që mbulojnë në treg, angazhohen të ofrojnë çdo informacion në dijeninë e tyre të nevojshëm dhe të domosdoshëm për realizimin e aktivitetit te Shoqërisë;
- 9.3 Ortakët angazhohen bashkarisht të kujdesen, mbledhin, hartojnë, përpunojnë, sistemojnë, organizojnë çdo dokument dhe të kryejnë çdo veprim të nevojshëm dhe të domosdoshëm për aplikimin pranë organeve shtetërore për pajisjen me lejet/autorizimet/miratimet/licensat dhe me çdo akt tjeter që u shërben të fitojnë të drejtën e realizimit të aktivitetit te Shoqërisë;
- 9.4 Ortakët angazhohen të lidhin një Marrëveshje Ortakësh (“**Marrëveshja e Ortakëve**”) për përcaktimin e raporteve dhe detyrave mes tyre, në lidhje me kontributin e tyre ne Shoqeri
- 9.5 Palët angazhohen të bëjnë përpjekjet maksimale për përbushjen dhe realizimin e qëllimit dhe objektit të këtij Statuti dhe të Shoqërisë së themeluar posaçërisht;
- 9.6 Palët angazhohen të respektojnë kushtin e Ekskluzivitetit përsa i përket objektit të aktivitetit të Shoqërisë sipas këtij Statuti (Neni 5.1) duke mos bashkëpunuar me palë të treta, ku përfshihen edhe institucione financiare, në mënyrë të pavarur dhe pa miratimin me shkrim të Ortakut AGROPHARMA SH.P.K.
- 9.7 Palët angazhohen dhe marrin përsipër të mbrojnë pronën intelektuale të secilës prej tyre, idetë dhe projektet që krijohen dhe realizohen nga secila Palë dhe i shërbijnë në mënyrë direkte ose të tërthortë qëllimit dhe objektit të kësaj Marrëveshje.
- 9.8 Përgjegjësitë e Shoqërisë garantohen nëpërmjet kapitalit të saj dhe Ortakët mund të mbajnë përgjegjësi vetëm brenda kufirit të vlerës së kapitalit; Ortakët nuk kanë asnjë përgjegjësi përtëj kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë (përveç garancive personale të dhëna për çdo kredi të Shoqërisë ose për detyrime të tjera).
- 9.9 Shoqëria nuk është përgjegjëse për borxhet ose detyrimet e tjera personale të Ortakëve.

## 10 Tjetërsimi i kuotave

- 10.1 Barra ose transferimi i kuotave në favor të palëve të treta kushtëzohet me pëlqimin me shkrim të seceilit prej ortakëve të Asamblesë së Përgjithshme.
- 10.2 Me përashtim të rastit kur me unanimitet Ortakët vendosin ndryshe apo dispozitat e këtij Statuti parashikojnë ndryshe, Ortaku i Pakices nuk mund të transferojë

6

- plotësish apo pjesërisht, të drejta të pronësisë mbi kuotat e Shoqërisë tek palët e treta nëpërmjet (i) një akti dhurimi/ pa pagesë inter vivos, (ii) një akti shkëmbimi (ex neni 757 i Kodit Civil), (iii) një kontributi në Shoqëri të treta ose (iv) çfarëdolloj akti tjetër që drejtëpërsëdrejti ose indirekt realizon transferimin e pronësisë së ortakëve të Shoqërisë tek të tretët.
- 10.3 Në çdo rast, në rast transferimi të kuotave në favor të palëve të treta, Ortakët që nuk transferojnë do të kenë të drejtën e preferencës në proporcionin e kuotave përkatëse në lidhje me një transferim të tillë, me kusht që ata të deklarojnë qëllimin e tyre për të blerë kuotat në Asamblenë e Përgjithshme duke diskutuar për pëlqimin për transferimin e kuotave.
- 10.4 Që në momentin e krijimit te Shoqërisë, çdo Ortak i Pakicës i jep Ortakut AGROPHARMA sh.p.k (KS) një të Drejtë Blerjeje të parevokueshme dhe te pakushtezuar për Kuotat e tij përkatëse në Shoqëri ("E Drejta e Blerjes"), sipas kushteve të përcaktuara në këtë Statut dhe në Marrëveshjen e Ortakëve të lidhur nga Ortakët ("Marrëveshja e Ortakëve"). AGROPHARMA (KS) mund të ushtrojë të drejtën e saj ndaj një Ortaku të Pakicës veçmas ose ndaj të gjithë Ortakëve të Pakicës njëkohësisht.
- 10.5 E Drejta e Blerjes mund të ushtrohet në mënyrë të përsëritur në diskrecionin e AGROPHARMA SH.P.K (Kosove). AGROPHARMA SH.P.K (Kosove), mund të ushtrojë të Drejtën e saj të të Blerjes ose të Drejtën e Shitjes ndaj një Ortaku të caktuar të Pakicës individualisht ose ndaj të gjithë Ortakëve të Pakicës në të njëjtën kohë. E Drejta e Shitjes mund të ushtrohet veçmas nga çdo Ortak i Pakicës .
- 10.6 Secili Ortak i Pakicës i jep AGROPHARMA SH.P.K (Kosove) sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Ortakëve një të drejtë të parevokueshme për të kërkuar që Ortakët e Pakicës t'i shesin të gjitha kuotat e tyre në Shoqëri ose një pjesë të tyre blerësit(ve) palë të treta tek të cilët AGROPHARMA SH.P.K (Kosove), synon të shesë kuotën e saj në Shoqëri në një transaksion të vetëm ose në një seri transaksionesh tregtare ("**E Drejta "Drag Along"**"). E Drejta "Drag Along" mund të ushtrohet nga AGROPHARMA SH.P.K (Kosove) në çdo kohë dhe në mënyrë të përsëritur në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Ortakëve.
- 10.7 AGROPHARMA SH.P.K (Kosove) i jep Ortakut të Pakicës për të gjitha kuotat e tij në Shoqëri ose një pjesë të saj, një të drejtë të parevokueshme që AGROPHARMA SH.P.K (Kosove), të mundësojë që pala e tretë blerëse të cilit AGROPHARMA

- SH.P.K ( Kosove) synon t'i shesë kuotën e saj në Shoqëri në një transaksion të vetëm ose në një seri transaksione të tregtare, që kjo palë e tretë blerëse të ofroje blerjen nga çdo Ortak i Pakicës i cili kërkon të shesë, të gjithë kuotën e tij në Shoqëri ("E Drejtë "Tag Along""). E Drejtë "Tag Along" mund të ushtrohet nga Ortaku i Pakicës në çdo kohë dhe në mënyrë të përsëritur në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Ortakëve.
- 10.8 Rregullat e përcaktuara në Nenin 10.1 dhe 10.2 më sipër nuk zbatohen në rast të performancës të së Drejtës së Blerjes, të së Drejtës së Shitjes, të së Drejtës "Drag Along" ose të së Drejtës "Tag Along".

## 11 Kompetencat dhe Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga Ortakët, secili me të drejtën e një vote, të barabartë në proporcionin me vlerën e kontributit të secilit anëtar në kapitalin e Shoqërisë, dhe që sebashku përfaqësojnë 100% të kapitalit.
- 11.2 Ortakëve do t'u jepet në çdo kohë, pa kërkesë me shkrim, nga drejtuesit e Shoqërisë, të gjitha informacionet dhe të dhënat në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë në çdo kohë,, duke përfshirë të drejtën për të inspektuar të dhënat dhe dokumentet e Shoqërisë.
- 11.3 Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme, të cilat kërkojnë një shumicë me 3/4 e votave, (**Vendimet Strategjike**) në përputhje me dispozitat e Nenit 86-88 të Ligjit Nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar ("**Ligji për Shoqëritë Tregtare**"):
- 11.3.1 ndryshimi i Statutit;
  - 11.3.2 zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
  - 11.3.3 pjestimin e kuotave te shoqerise dhe anullimin e tyre
  - 11.3.4 riorganizimi i Shoqërisë dhe prishjen apo likuidimi i saj;
  - 11.3.5 shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- 11.4 Asambleja e Përgjithshme do të vendosë për çështjet e mëposhtme, të cilat kërkojnë shumicë të thjeshtë, në përputhje me dispozitat e Nenit 86 dhe 88 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare:
- 11.4.1 themelimin dhe likuidimin e shoqërive bija të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
  - 11.4.2 emërimin dhe revokimin e Administratorit dhe drejtorëve

- 11.4.3 miratimin e pasqyrave financiare për vitin e fundit finanziar pas shqyrtimit të saj nga ortakët;
- 11.4.4 miratimin e planeve financiare vjetore dhe planeve afatgjata të biznesit të Shoqërisë;
- 11.4.5 emërimi i një eksperti kontabël;
- 11.4.6 përcaktimin e rregullave për punësimin dhe kompensimin e anëtarëve të saj Drejtues;
- 11.4.7 caktimin e një përlaqësuesi, një përfaqësuesi tregtar dhe një përfaqësuesi të biznesit;
- 11.4.8 vendimin për detyrimet dhe pergjegjesite e Ortakëve për pagesat shtesë dhe rimbursimin e tyre;
- 11.4.9 përsaqësimin e Shoqërisë në procedurat gjyqësore kundër anëtarëve të saj Drejtues;
- 11.4.10 dhënien e pëlqimit për Shoqerinë që (i) në çdo rast të japë një hua dhe kredi dhe (ii) të marrë një hua dhe kredi në vlerë më të madhe se 100.000 euro (njeqind mijë euro) në një ose një seri transaksionesh të ndërlidhura; ose ekuivalenti i tij në monedha të tjera, i cili nuk është parashikuar në planet financiare dhe të biznesit të Shoqërisë të miratuara në përputhje me dispozitat e Statutit;
- 11.4.11 dhënia e pëlqimit për blerjen ose disponimin e një pasurie të paluajtshme nga Shoqëria, ose një pjesë në pasuri të paluajtshme ose uzufrukti të përhershëm, pavarësisht nga vlera e së drejtës së fituar ose të disponuar, që nuk është parashikuar në planet financiare dhe të biznesit të shoqërisë të miratuara në përputhje me dispozitat e Statutit;
- 11.4.12 çdo transaksion ose veprim, si (a) shitja ose blerja e aktiveve fiksë me vlerë më të madhe se 10.000 Euro (dhjete mijë euro) (individualisht ose në seri transaksionesh) dhe/ose (b) blerja ose shitja e materialeve të palëve të treta brenda operacione të rregullta të biznesit të pagesave me vlerë mbi/nen 10 % (dhjete përqind) te parashikimit te planeve financiare dhe të biznesit të Shoqërisë të miratuara në përputhje me dispozitat e Statutit (individualisht ose në seri transaksionesh) dhe/ose (c) blerje të shërbimeve dhe materialeve të palëve të treta që i nënshtrohen pikës (b), më sipër, me vlerë mbi 10.000 Euro (dhjete mijë euro) (individualisht ose në seri transaksionesh), e cila nuk është

parashikuar në planet financiare dhe të biznesit të Shoqërisë të miratuara në përputhje me dispozitat e Statutit;

11.4.13dhënien e ndonjë garancie, ose marrjen përsipër të detyrimeve të tjera jashtë bilancit nga Shoqëria, ose marrjen e detyrimeve për të korriguar dëmin: (a) që lidhen me detyrimet kontraktuale të Shoqërisë të bëra në kuadër të operacioneve të rregullta të biznesit të pagesave me vlerë më të madhe se 5000 Euro (pese mijë euro), ose (b) në çdo rast tjetër, që nuk është parashikuar në planet financiare dhe të biznesit të Shoqërisë të miratuara në përputhje me dispozitat e Statutit.;

11.4.14dhënien e pëlqimit për shitjen, dhënien me qira, pengun, pengun e regjistruar, hipotekën ose çdo barrë tjetër ose disponim të ndonjë pjese të aktiveve të Shoqërisë, e cila nuk është parashikuar në planet financiare dhe të biznesit të Shoqërisë të miratuara në përputhje me dispozitat e Statutit;

11.4.15dhënien e pëlqimit për blerjen ose abonimin për aksione të shoqërive të tjera tregtare nga Shoqëria, ose hyrjen në partneritete ose sipërmarrje të përbashkëta;

11.4.16dhënia e pëlqimit për tjetësimin, barrësimin ose transferimin pa kundërshpërblim të të drejtave të autorit dhe të të drejtave për shpikjet, të të drejtave të pronësisë industriale ose të të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale, dhe në veçanti të drejtat për kodet kompjuterike dhe markat tregtare, të cilat nuk janë parashikuar në gjendjen financiare të Shoqërisë dhe planet e biznesit të Shoqërisë të miratuara në përputhje me dispozitat e Statutit;

11.4.17dhënia e pëlqimit për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet Shoqërisë, filialeve ose shoqërive të lidhura të saj dhe anëtarëve të menaxhimit të Shoqërisë (drejtorëve), ose palëve të lidhur me ta; dispozita e mësipërme nuk i referohet marrëveshjeve të bëra ndërmjet drejtorit dhe një shoqërie që i përket të njëjtit grup kapitali si Shoqëria;

11.4.18dhënia e pëlqimit për punësimin nga Shoqëria të këshilltarëve ose personave të tjera që nuk janë punonjës të Shoqërisë si konsulentë, avokatë ose agjentë, nëse kostoja vjetore e lidhur me punësimin e këtyre personave nga Shoqëria tejkalon 10.000 Euro (dhjete mijë euro) ose ekuivalentin në monedha të tjera, me një angazhimi të supozuar prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh;

- 11.4.19 dhënia e pëlqimit për shpenzimet dhe marrja përsipër e detyrimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara këtu me vlerë mbi 10.000 Euro (dhjete mijë euro) në një ose një seri transaksionesh të ndërlidhura, ose ekuivalentin e tyre në monedha të tjera, të cilat nuk janë parashikuar në planet e biznesit dhe plae finançiare të Shoqërisë të miratuara në përputhje me dispozitat e Statutit;
- 11.4.20 përcaktimin e pagave të anëtareve të saj Drejtues;
- 11.4.21 çështje të tjera të parashikuara me ligj.
- 11.5 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të regjistrohen në regjistrin e Vendimeve, i cili ruhet në selinë e Shoqërisë.
- 11.6 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime qarkulluese me shkrim.
- 11.7 Në rastet kur Ortakët nuk marrin vendim në lidhje me çështjet e parashikuara nga nisi 11.3, për të cilat kërkohet vendimarrje me shumicë të cilësuar të cilat kërkohet të votohen në Asamblenë e Ortakëve, Shoqëria konsiderohet të ndodhet para rastit të ashtuquajtur Bllokim në Vendimarrje ("**Bllokim Vendimarrjeje**"). Në këtë rast, Ortakët angazhohen dhe bien dakord të caktojnë një mbledhje të dytë të Asamblesë së Përgjithshme, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e Mbledhjes së mëparshme, ku të merren dhe një herë në shqyrtim çështjet për të cilat pati Bllokim Vendimarrjeje në mbledhjen e mëparshme të Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.8 Në rast se Ortakët, edhe në këtë mbledhje të dytë të Asamblesë së Përgjithshme nuk marrin vendim në lidhje me çështjet për të cilat kërkohet vendimarrje, sërisht në kushtet e Bllokimit në Vendimarrje, atëherë Ortakët do caktojnë një mbledhje të tretë të Asamblesë së Përgjithshme, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e Mbledhjas së mëparshme, ku të merren dhe një herë në shqyrtim çështjet për të cilat pati në Bllokim Vendimarrjeje në mbledhjen e mëparshme të Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.9 Në rast se Ortakët, edhe në këtë mbledhje të tretë të Asamblesë së Përgjithshme nuk marrin vendim në lidhje me çështjet për të cilat kërkohet vendimarrje dhe janë sërisht në kushtet e Bllokimit në Vendimarrje, atëherë do të zbatohen parashikimet e nenin 10.4.1 të këtij Statuti. Ortaku AGROPHARMA SH.P.K (Kosove) duhet të ushtrojë të drejtën për blerjen e kuotave të Ortakëve të Pakicës brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga data e mbledhjes së tretë të Asamblesë së Përgjithshme, sipas nenit 11.8.

S. 11

- 12. Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**
- 12.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/(-rët) apo prej Ortakëve zotërues të të paktën 5% të votave sipas legjislacionit në fuqi.
  - 12.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpermjet një njoftimi me shkrim me lajmërim marrje, ose postë elektronike me lajmërim marrje.
  - 12.3 Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet Ortakëve brenda 5 (pesë) ditëve para datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
  - 12.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjeter brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
  - 12.5 Asambleja e Përgjithshme shprehet në mënyrë të veçantë për çdo çështje të rendit të ditës, për të cilën duhet të merret një vendim i veçantë.
  - 12.6 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë/autorizim me shkrim, i cili do të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, duke përfshirë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. Administratori/(-ët) e Shoqërisë nuk mund të përfaqësojnë Ortakët në Asamblenë e Përgjithshme.
  - 12.7 Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpermjet mjeteve elektronike të audiove dhe video-konferencës.
  - 12.8 Përdorimi i mjeteve elektronike për t'u mundësuar Ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e Ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në ate masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

## KAPITULLI V

### Administrimi i Shoqërisë

**13. Administrimi**

- 13.1 Shoqëria do të përfaqësohet dhe Administrohet nga 1 (një) Administrator, i cili do të emërohet dhe revokohet ekskuzivisht nga Ortaku AGROPHARMA SH.P.K.
- 13.2 Detyrat dhe përgjegjësitë e Administratorit përcaktohen me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare (përsa i përket Administratorit) dhe me këtë Statut aktual.
- 13.3 Administratori do të përfaqësojë shoqërinë kundrjet palëve të treta dhe do të jetë përgjegjës për punët e përditshme të Shoqërisë, duke iu nënshtuar kufizimeve të

12

- parashikuara nga Statuti dhe ligji në fuqi, ose ndonjë vendim që mund të miratohet herë pas here nga Asambleja e Përgjithshme.
- 13.4 Mandati i Administratorit do të jetë 5 (pesë) vjet, nga data e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për emerimin e tyre, me të drejtë riemërimi.
- 13.5 Përveç rasteve kur Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe, Administratori, brenda fushës së kompetencave të tij, do të:
- 13.5.1 respektojë Ligjin për Shoqërîtë, Tregtare, Statutin e Shoqërisë dhe aktet e brendshme dhe zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
  - 13.5.2. sigurohet që auditimi i librave dhe regjistrave të kryhet të paktën çdo vit nga eksperti kontabël i pavarur, dhe do të dorëzojë raportin e ekspertit kontabël në Asamblenë e Përgjithshme (dhe do të sigurohet që një draft i tillë i raportit të ekspertit kontabël t'i dërgohet secilit Ortak siç kërkohet me ligj;
  - 13.5.3 miratojë rregullat operacionale dhe procedurale dhe të miratojë organizimin e brendshëm të Shoqërisë në përputhje me ligjin dhe këtë Statut dhe aktet e brendshme të Shoqërisë;
  - 13.5.4 emërojë, largojë, punësojë dhe shkarkojë punonjësit e Shoqërisë, të përcaktojë çdo kompensim për ta, të monitorojë performancën e tyre dhe të nxjerrë udhëzime të përgjithshme për ta dhe të delegojë këtë autoritet tek drejtuesit dhe anëtarët e tjerë stafit;
  - 13.5.5 paraqesë në Asamblenë e Përgjithshme një propozim në lidhje me organizimin e brendshëm të Shoqërisë;
  - 13.5.6 sigurohet që të gjitha dosjet, publikimet dhe/ose deklarimet e nevojshme të bëhen pranë autoriteteve përkatëse, siç mund të kërkohet nga ky Statut dhe aktet e brendshme të Shoqërisë;
  - 13.5.7 veprojë në mirëbesim për të mirën e Shoqërisë;
  - 13.5.8 të ushtrojë kompetencat e dhëna atij/asaj në përputhje me interesin më të mirë të Shoqërisë;
  - 13.5.9 shmangë dhe zbulojë konfliktet aktuale dhe të mundshme midis interesave të tij/saj personale dhe atyre të Shoqërisë. Kur ai/ajo ka një konflikt të tillë interesit, ai/ajo nuk duhet të marrë pjesë dhe aty ku është e përshtatshme të largohet nga mbledhja

- 13.5.10të ushtrojë kujdes dhe aftësi të arsyeshme në kryerjen e funksioneve të tij/saj; dhe të trajtojë si konfidenciale të gjitha informacionet e marra gjatë kryerjes së detyrate të tij/saj.
- 13.6 Një person nuk mund të emërohet si Administrator i Shoqërisë, dhe as nuk mund të mbajë asnjë pozicion tjeter në Shoqëri, nëse ai/ajo është punonjës, nëpunës ose drejtor, ortak, ose ka një interes finansiar të drejtpërdrejtë apo të tirthortë, apo lidhje familjare, në ndonjë shoqëri tjeter që konkuron me Shoqërinë dhe/ose kryen të njëjtin ose në thelb të njëtin biznes si Shoqëria. Çdo zgjedhje e bërë në kundërshtim me dispozitat e këtij neni do të jetë e pavlefshme.
- 13.7 Administratori, si dhe cdo punonjës tjeter i Shoqërisë, do të respektojnë çdo politikë, procedurë duke marrë në konsideratë parashikimet e Statutit dhe në veçanti do t'u deklarojnë Ortakëve çdo interes finansiar që ata mund të kenë në lidhje me Shoqërinë ose shoqëritë e lidhura me të:
- 13.7.1 konkurrentët e biznesit;
  - 13.7.2 kreditorët;
  - 13.7.3 furnizuesit e mallrave ose shërbimeve; dhe
  - 13.7.4 klientët e biznesit.
- 13.8 Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuar nga seksioni i mëparshëm do të bëhen nga çdo individ në kohën kur lind interes finansiar ose në kohën kur individi bëhet drejtues, anëtarësohet ose punësohet nga Shoqëria. Nëse një punonjës i Shoqërisë nuk arrin të bëjë një deklaratë për dhënie informacioni siç kërkohet nga ky Statut, ai/ajo mund të jetë përgjegjës deri në masën që Shoqëria është dëmtuar si rezultat i një mos-deklarimi të tillë

#### **14. Administratori**

- 14.1 Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.
- 14.2 Administratori i pare i Shoqërisë është:  
**Z. Enea Thomaj**, lindur më date 12.02.1993, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036352167 dhe nr. personal J30212028S, banues në Lushnjë, me adresë në rrugën Loni Dhamo,
- 14.3 Kompetencat e Administratorit që përfaqëson Shoqërinë përfshijnë:

- 14.3.1 T'i propozojë Asamblesë së Përgjithshmë për miratim çdo vendim lidhur me çështjet në kompetence të Asamblesë së Përgjithshme;
- 14.3.2 Të menaxhojë aktivitetin e përditshëm të Shoqërisë duke zbatuar politikat dhe planet e vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- 14.3.3 Të përfaqësoje Shoqërinë përkundrejt palëve të treta;
- 14.3.4 Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- 14.3.5 Të përgatisë dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor dhe bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për t'ia paraqitur Asamblesë së Përgjithshme për shpërndarjen e fitimeve;
- 14.3.6 Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- 14.3.7 Të kryejë regjistrimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, pranë QKB-së siç mund të kërkohet;
- 14.3.8 Të raportojë përpara Ortakëve për zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e transaksioneve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- 14.3.9 Të kryejë detyra të tjera sipas vendimeve të Ortakëve apo të përcaktuara në ligj, herë pas here.
- 14.4 Administratori do të mbikëqyrë dhe do të sigurohet se punëmarrësit, agjentët, punonjësit, ekspertët kontabël të autorizuar dhe këshilltarët e Shoqërisë do të tregojnë kujdesin e duhur dhe në interesin më të mira të Shoqërisë.
- 14.5 Përveç detyrave të përgjithshme të parashikuara sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori duhet:
- 14.5.1 të kryejë detyrat e tij në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, çdo ligji the zbatueshëm apo këtë Statut, me mirëbesim dhe në interesat më të mira të Shoqërisë, përfshirë qëndrueshmërinë mjedisore të aktiviteteve të saj;
- 14.5.2 të ushtrojë kompetencat që i jepen atij sipas ligjit apo këtij Statuti vetëm për qëllimet e caktuara aty;
- 14.5.3 të vlerësojë siç duhet të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Shoqërinë dhe të marrë çdo vendim të nevojshëm;
- 14.5.4 të shbangë konfliktet e mundshme ndërmjet interesave të tij personale dhe atyre të Shoqërisë;

- 14.5.5 të tregojë kujdesin dhe të përdorë aftësitë në mënyrë të arsyeshme në ushtrimin e detyrave të tij.
- 14.6 Sipas udhëzimeve dhe vendimeve me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme, Administratori mund të autorizojë drejtore ose persona të tretë individë për të vepruar për llogari të tij dhe për të përfaqësuar Shoqërinë tek të tretët për çështje specifike për zgjidhje sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.7 Administratori mund të caktojë një përfaqësues dhe t'i japë një përfaqësuesi të tillë çdo prokurë të per gjithshmë / autorizim për të kryer çdo dhe të gjitha veprimtaritë për administrimin e Shoqërisë, pasi të ketë marrë një autorizim paraprak me shkrim nga Asambleja e Përgjithshme.
- 14.8 Kompetencat e Administratorit do të jenë të kufizuara sipas parashikimeve të mëposhtme Administratorit:
  - 14.8.1 Administratori ka Kufizimet e Kompetencave si më poshtë të përcaktuara dhe nuk mund të veprojnë veçmas dhe pa marrë miratimin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas kuorumit të kërkuar në pikën 11.4 më sipër:
    - i. Të marrin vendime dhe të kryejnë veprime mbi një, disa ose të gjitha çështjet e përcaktuara në pikën 11.4 të nenit 11 të këtij Statuti pa marrë miratimin e Asamblesë së Përgjithshme sipas kuorumit të përcaktuar në këtë pikë;
- 14.9 Për një, disa ose të gjithë kategorinë e veprimeve të listuara në pikën 11.4 të nenit 11 të Statutit dhe në përputhje me Kufizimet e Kompetencave si më sipër të përcaktuara, Administratori do të veprojë vetëm me miratim me vendim nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë sipas pikës 11.4 më sipër. Asambleja e Përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sipas pikës 11.3, të këtij Statuti, ka të drejtë të ngreje padi përpara gjykates kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratoreve, si pasoje e shkeljes së rëndë të ligjit dhe/ose të statutit të Shoqërisë.

## KAPITULLI VI

### Administrimi Financiar dhe Kontabël i Shoqërisë

#### **15. Eksperti Kontabël**

Asambleja e Përgjithshme do të caktojë një ekspert kontabël të pavarur për auditimin e Shoqërisë në përputhje me ligjin shqiptar.

#### **16. Viti Financiar**

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Viti i parë financiar fillon në datën e themelimit të Shoqërisë.

#### **17. Librat Kontabël**

Shoqëria do të mbajë kontabilitetin në monedhën shqiptare (LEK) dhe në monedhë të huaj si edhe do të përgatisë bilancin dhe pasqyrën e fitim-humbjeve sipas ligjit shqiptar.

#### **18. Shpërndarja e Fitimeve**

- 18.1 Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilanceve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme. Çdo shpërndarje e fitimit miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.
- 18.2 Shoqëria do të krijojë fondin rezervë nga fitimet e saj vjetore sipas dispozitave ligjore të detyrueshme të ligjit Shqiptar për rezervën ligjore të detyrueshme.

## KAPITULLI VII

### Të ndryshme

#### **19. Gjuha**

Ky Statut hartoitet në 5 (pesë) kopje në gjuhën Shqipe.

#### **20. Dispozitat Përfundimtare**

- 20.1 Çështjet që nuk rregullohen shprehimisht në këtë Statut do të rregullohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

ORTAKËT NËNSHKRUES  
TË  
AKTIT TË THEMELIMIT DHE TË STATUTIT TË SHOQËRISË ME  
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“AGROPHARMA AL” SH.P.K

AGROPHARMA SH.P.K

  
A circular blue stamp with the text "AGRO-PHARMA SH.P.K." around the perimeter and the number "1" in the center.

Z. ENEA THOMAJ

